

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I QARKUT KUKES

VENDIM

Nr. 9 Date 12/02/2013

PER
MIRATIMIN E RREGULLORES SE PROÇEDURES SE DHENIES SE
"TITUJVE TE NDERIT"

Këshilli i Qarkut Kukës në mbledhjen e tij të datës së mesipërme, pas shqyrtimit të Relacionit dhe P/vendimit të paraqitur nga Drejtoria Juridike, bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë nëni 113, ligjin Nr.8652 datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore,, nën 7/2, 8/VII/a, 54/m/nj, si dhe ligjin Nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë",

VENDOSI:

1. Të miratojë Rregulloren mbi procedurën e dhenies së "Titujve të Nderit" bashkangjitur këtij vendimi.
2. Vendimi i Kryesise së Keshillit të Qarkut Kukës Nr.4 datë 15.05.2009 "Për miratimin e Rregullores mbi procedurën e dhenies së titujve të nderit nga Keshilli i Qarkut Kukës" shfuqizohet.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari, Sekretari i Keshillit të Qarkut Kukës, si dhe Drejtoria Juridike dhe Finances.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

KRYETARI

Ibsen ELEZI

Konc: Z.Elezi


Ligjshmeria: G.Çejku

Sekretari: B.Ngjeçi

U hartua në 3 (tre) kopje origjinale:

1. Zyres së Protokoll Arkivit

2. Institucionit të Prefektit Qarkut Kukës



RREGULLORE MBI PROÇEDURËN E DHËNIES SË TITUJVE TË NDERIT

Kjo rregullore është hartuar në bazë të Kushtetutes se Republikës se Shqipërisë neni 113, ligjit Nr.8652 datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" 8/vii/a dhe 54/m si dhe ligjit Nr.8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", nepermjet se ciles percaktohen rregullat dhe proçedurat për dhenien e "Titujve te Nderit" nga Keshilli i Qarkut Kukes.

Neni 1

Titujt e nderit u jepen individëve dhe personaliteteve te ndryshme, në përshtatje me kontributet dhe vlerat, rolin dhe ndikimin e tyre në opinionin publik.

Neni 2 Titujt e Nderit

1. Këshilli i Qarkut Kukes jep keta tituj nderi:

- ❖ Nderi i Qarkut Kukes
- ❖ Personalitet i shquar ne fushen... (emri i fushes)

Këta tituj jane te barazvlefshem dhe jepen duke marrë parasysh shkallën e rëndësisë së veprimtarisë dhe kontributit te personit te propozuar.

2. Kryetari i Keshillit te Qarkut jep këtë titull nderi:

- ❖ Çertifikate (Mirenjohje)

Neni 3 Pershkrimi i Titujve te Nderit

NDERI I QARKUT KUKES: U jepet qytetareve shqiptarë dhe të huaj per akte të veçanta heroike, dhe humanizmi, per kontribut dhe sherbime te veçanta ne dobi te Qarkut Kukes si dhe promovimit te vlerave dhe imazhit te tij jashte vendit.

PERSONALITET I SHQUAR: U jepet qytetareve shqiptarë dhe të huaj per veprimtari te spikatur ne fushat e ndryshme te shkences, artit, arsimit, kultures dhe sportit ne dobi te Qarkut Kukes.

MIRENJOHJE: U jepet qytetareve shqiptarë dhe te huaj ne shenje nderimi dhe falenderimi per kontributin dhe veprimtarine e tyre ne dobi te Qarkut Kukes.

Neni 4

E drejta e propozimit për dhenien e titujve te nderit

Të drejten per te propozuar dhenien e titujt te nderit e ka çdo njesi e qeverisjes vendore, keshilltare te Qarkut, drejtues te institucioneve publike dhe jopublike rajonale, organizatat jofitim-pruresse te cilet nepermjet kesaj te drejte synojnë të evidentojnë e nxisin kontribute e vlera të veçanta në dobi të shoqërisë si dhe për të vlerësuar e respektuar mbartësit e tyre.

Neni 5

Motivacioni i titullit

Për çdo propozim per dhenie titull nderi, motivacioni duhet te jete i veçante, i plote dhe ne menyre te permbledhur.

Neni 6

Propozimi per dhenie titull nderi

Propozimi për dhenie titull nderi është i plotë dhe shqyrtohet në kohën e duhur kur plotëson kriteret e mëposhtme:

- a) Dërgohet rreth tre muaj para veprimtarisë, përvjetorit apo ngjarjes historike që i përket individit apo institucionit.
- b) Kur propozimi firmoset nga titullari i institucionit që ka të drejtën e propozimit ose nga perfaqësuesi i shoqërisë civile.
- c) Shoqërohet me relacionin përkatës ku paraqiten arritjet dhe meritat e veçanta të propozuarit.
- d) Përmban CV-ne e personit dhe arsyetimin rreth motivacionit.
- e) Letër pranimit të titullit të nderit nga personi përkatës.
- c) Si dhe dokumenta të tjera plotësues mbi veprimtarinë ose aktivitetin e personit të propozuar.

Neni 7

Kriteret e propozimit

Të propozuarit për dhenien e titullit të nderit, në përputhje me titullin e propozuar, duhet të kenë arritje, kontribute dhe vlera të veçanta në shërbim dhe në dobi të Qarkut Kukës.

- a. Propozimi bëhet duke mbajtur parasysh meritat e individit në përputhje që ai të jetë në përshtatje me llojin e titullit, vlerat e ndikimit në opinionin publik
- b. I njëjti titull nuk mund të jepet dy herë.
- c. Nuk mund të jepet titull më e ulët nga një titull më i lartë i dhënë më parë
- d. Propozimi nuk mund të bëhet për ata persona që janë të dënuar për shkelje të ligjit ose janë në hetim.

Neni 8

Procedura e miratimit

Praktika dhe procedurat për miratimin e titujve të nderit ndiqen nga Drejtoria Juridike.

- a) Të gjitha propozimet, nëpërmjet protokollit, i kalojnë për ndjekje Drejtorisë Juridike.
- b) Drejtoria Juridike verifikon nëse materiali propozues për titull nderi është i plotë sipas kërkesave të ligjit dhe kësaj rregullore. Kur materiali propozues nuk është i plotë i kërkon me shkrim institucionit propozues brenda 15 ditëve plotësimin e dokumentacionit përkatës. Riparaqitja e plotësimin bëhet jo më vonë se 15 ditë nga marrja e njoftimit.
- c) Nëse materiali propozues për titull nderi është i plotë e paraqet për shqyrtim e miratim në komisionin për shqyrtimin e propozimeve për tituj nderi dhe me miratimin nga komisioni e paraqet për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Qarkut.
- d) Kur propozimi miratohet nga Këshilli i Qarkut, dhe pas verifikimit të ligjshmerisë së vendimit nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut, Drejtoria e Teknologjisë Informacionit, Programimit dhe Statistikave përgatit **Çertifikatën** për dhenien e titullit të nderit.
- e) Pas firmosjes së vendimit dhe çertifikatës nga Kryetari i Këshillit të Qarkut, Drejtori i Drejtorisë Juridike, njofton institucionin propozues për miratimin e propozimit, për organizimin e ceremonisë për dhënien e titullit, programin, kohën dhe vendin ku do të zhvillohet ceremonia.

- f) Proçedurat për shqyrtimin dhe miratimin e një titulli nderi zgjasin jo më pak se 3 (tre) muaj.
- g) Kur propozimi për dhenie titull nderi nuk miratohet, Drejtoria Juridike, i bën njoftimin institucionit propozues për mos-miratimin.
- h) Zyra e Arkivit, bën regjistrimin e titullit në librin e Regjistrit të Protokollit të "Titujve të Nderit".
- i) Vendimi i miratimit të "Titullit të Nderit" publikohet në Website-in Zyrtar të Keshillit të Qarkut.
- j) Praktikat e përfunduara arkivohen.

Neni 9

Cermonia e dhenies së titullit

Ceremonia e dhënies së titullit organizohet nga institucioni propozues në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike. Shpërndarja e titujve të nderit duhet planifikuar të bëhet në rastet kur:

- a) Dhënia e tyre është e lidhur me përvjetorë e ngjarje historike e aktuale, festat kombëtare e rajonale, gjatë takimeve dhe vizitave zyrtare.
- b) Dhënia e titujve bëhet me ceremoni publike / jopublike.
- c) Institucioni propozues informon Drejtorinë Juridike ose drejtpërdrejt Sekretarin e Keshillit të Qarkut për mënyrën e organizimit të ceremonisë.
- d) Titullin e Nderit e jep Kryetari i Keshillit të Qarkut, ose persona të deleguar personalisht nga ai
- e) Titulli i jepet personit që dekorohet. Nëse dhënia e titullit të nderit bëhet pas vdekjes, Çertifikata u jepet familjarëve të personit të propozuar.
- f) Çertifikata përmban emrin e personit të cilit i jepet titulli, titullin e dhënë, motivacionin e personalizuar, numrin e vendimit, firmoset nga Kryetari dhe vuloset me vulën e Keshillit të Qarkut.

Neni 10

Dispozita të fundit

Kjo rregullore mund të ndryshohet me aneks të veçantë.

Neni 11

Për ndjekjen dhe zbatimin e kësaj Rregulloreje ngarkohet Sekretari i Keshillit të Qarkut Drejtoria Juridike si dhe Drejtoria e Teknologjisë Informacionit, Programimit dhe Statistikave

Neni 10

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Keshilli i Qarkut Kukës.

KRYETARI
Ibsen ELEZI

